

7 janar 2026,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 07.01.2026, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.20/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KB Vëllaznimi për regjistrimin e lojtarit Derek Wilson si lojtar i lirë ("free agent")¹ jashtë afatit kalimtar.
- II. Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë dhe në bazë të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026, Komisioni i Garave **REFUZON** kërkesën e KB Vëllaznimi për lejimin e regjistrimit të lojtarit Derek Wilson.
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit.

¹ **Lojtar i lirë (free agent)** – lojtar të cilit i ka përfunduar kontrata me ekipin e tij të mëparshëm (nuk ka kontratë aktive/valide) dhe është i lirë të nënshkruajë një kontratë të re me cilindo ekip tjetër. Një lojtar i lirë ka të drejtë të negociojë dhe të pranojë oferta nga ekipet e tjera pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.20/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:


(a) **Komisioni i Garave i FBK-së**, duke shqyrtuar kërkesën e klubit **KB Vëllaznimi** për regjistrimin e lojtarit **Derek Wilson** si lojtar i lirë (free agent) jashtë afatit kalimtar, konstatoi si në vijim:

1. KB Vëllaznimi ka paraqitur kërkesë për regjistrimin e lojtarit Derek Wilson jashtë afatit kalimtar, duke u thirrur në statusin e tij si lojtar i lirë.
2. Nga verifikimet e bëra nga Komisioni i Garave rezulton se lojtari Derek Wilson në sezonin e kaluar ka qenë i angazhuar me klubin **KB Golden Eagle Ylli** dhe pas përfundimit të atij sezoni nuk ka qenë i regjistruar në asnjë klub tjetër, duke figuruar aktualisht si lojtar pa skuadër.
3. Megjithatë, bazuar në **Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026**, ne kete rast bazuar nenin 23.6 plotësohen kushtet nga: **Kapitulli IX, Neni 30, pika 4**, e cila përcakton se *transferimi i lojtarëve të huaj ndërmjet klubeve të Kosovës lejohet vetëm gjatë afatit kalimtar, nën kushte identike si për lojtarët vendorë*,
4. Komisioni i Garave vlerëson se regjistrimi i lojtarit Derek Wilson si lojtar i huaj, edhe pse i lirë, **nuk lejohet jashtë afatit kalimtar**, sepse **nuk plotësohen kushtet ligjore** për regjistrimin e lojtarit në këtë fazë të sezonit.
5. **Komisioni i Garave nga këto arsye Refuzohet** kërkesa e KB Vëllaznimi për regjistrimin e lojtarit Derek Wilson si lojtar i lirë jashtë afatit kalimtar.
6. **Udhëzohet** se lojtari Derek Wilson mund të regjistrohet për klubin **KB Vëllaznimi** me të drejtë loje **pas hapjes së afatit kalimtar dimëror**, në përputhje me rregulloret në fuqi.

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.